



UNIVERSITETI I TIRANES
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE



FILLIMI RRETH FAKULTETIT » DEPARTAMENTET » STUDENTET » KERKIMI DHE BOTIME » NJOFTIME DHE NGJARJE GALERIA KONTAKT

PROJEKTE BASHKEPUNIMI

Projekti ERASMUS +

RRETH PROJEKTIT

I dashur vizitor

Faleminderit që po vizitoni faqen e projektit tonë!

Titulli i projektit

“Përgatitja e moduleve për legjislacionin dhe të drejtat në programet e mësuesisë dhe të shkencave të edukimit: një kontribut për të ndërtuar sisteme edukimi të bazuara në të drejtat në vendet në tranzicion”

Tipi i projektit: Erasmus+ Mundus Zhvillim i kurrikulës

Data e fillimit: 15-10-2016

Data e mbylljes: 15-10-2019

Koordinator:

Vrije Universiteit Brussel (VUB)

Koordinator i projektit:

Prof. Gracienne LAUWERS

<http://edulaweu.eu/>

Konteksti i projektit

Projekti presupozon se bashkëpunimi mes edukatorëve dhe juristëve mund të nxisë mesimdhënien, të nxënit, udhëheqjen efektive të shkollës si dhe risitë arsimore. Pyetja kryesore e projektit që lidhet me multidisiplinaritetin dhe ndërdisiplinaritetin është se sa mirë bashkëpunimi ndërmjet edukatorëve dhe juristëve mund ta përmirësojë arsimin. Cilat janë tendencat në fushën e legjislacionit dhe të arsimit që e bëjnë gjithnjë e më të nevojshëm një bashkëpunim të efektshëm? Në shoqëritë demokratike, vendimet që ndikojnë në sjelljen e njeriut janë forca kryesore e cila përcakton orientimin e institucioneve arsimore nga dita në ditë. Shumë vendime gjyqësore për çështje të paraqitura nga studentë individualisht ose anëtarë të stafit kanë patur lidhje me kufizimin e lirisë së veprimit për çështjet kryesore të arsimit dhe të udhëheqjes së shkollës. Prandaj, një bashkëpunim efektiv mes edukatorëve dhe juristëve do të ndikonte në mënyrë të ndjeshme çështje të tilla, si qeverisja e shkollës, reforma shkollore, barazia e mundësive arsimore, drejtimi i shkollës, dhe shpërndarja e burimeve të pakta. Në shoqëritë demokratike, paraqitet një nevojë në rritje për një bashkëpunim të tillë. Në kontrast me këtë dukuri dhe nevojat, ka një mungesë të mjetëve mësimore për legjislacionin dhe të drejtat në arsim në dispozicion të profesionistëve në arsim. Për shkak të bashkëpunimit të kufizuar dhe mjetëve në dispozicion për të nxënit, shumë edukatorë/bordet e shkollave dhe juristë nuk janë të angazhuar në bashkëpunim të vazhdueshëm. Së fundi, një bashkëpunim i tillë ndërdisiplinor do të përmirësonte jo vetëm ndërveprimet juristë-edukatorë, por mund edhe të reduktonte proceset gjyqësore për çështjet arsimore, si dhe do të mundësonte përdorimin e legjislacionit për të mbështetur dhe për të çuar përpara objektivat e politikës arsimore.

Qëllimet

- o Të mbështeten vendet partnere për të përditësuar kurrikulat e tyre;
- o Të përgatiten më mirë stafi dhe studentët e vendeve partnere për një proces qeverisjeje të shkollës dhe një proces mesimdhënieje të bazuar në të drejtat dhe për t’u përgjigjur të drejtave pro-aktive në shoqëritë në tranzicion.

Objektivat

- o Të përmirësohet përgatitja e mësuesve për të zhvilluar një treg pune dhe shoqëri të bazuar në të drejtat ;
- o Të përmirësohet niveli i kompetencave dhe aftësive të kultivuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë duke zhvilluar module të reja on-line dhe programe të reja të përgatitjes së mësuesve.


Objektiva specifike

- o Të rihartohen kurset dhe programet e përgatitjes së mësuesve dhe të shkencave të edukimit duke përfshirë module që të transferojnë njohuri themelore të legjislacionit arsimor për studentët e mësuesisë dhe të shkencave të edukimit me ose pa një arsimim të mëparshëm ligjor;
- o Të zhvillohen mjetet për të nxënit dhe mesimdhënien për legjislacionin arsimor dhe të drejtat në arsim;
- o Të krijohen burime të hapura arsimore dhe një sistem online të testimit;

MANUAL

Mbi Përdorimin e Sistemit Informatik nga Studentët

PORTALI STUDENTOR



PORTALI PER ADMINISTRATEN



FAQE TE NGJASHME

Universiteti i Tiranës
Ministria e Arsimit dhe Sportit

- o Të rritet bashkëpunimi efektiv ndërmjet edukatorëve dhe juristëve të specializuar në fusha të ndryshme të së drejtës;
- o Të mbështeten partnerët me metodologjitë dhe qasjet pedagogjike përfshirë përshkrimin e rezultateve të të nxënit për secilin nga modulet;
- o Të zhvillohet një qasje inovative për përgatitjen e mësuesve dhe rolin e ligjit në fushën e arsimit;
- o Të përmirësohet niveli profesional i stafit;
- o Të lidhet arsimimi i mësuesve me standardet ndërkombëtare.

INSTITUCIONET PJESËMARRËSE NË PROJEKT

Free University of Brussels

Vytauto Didžiojo Universitetas

University of Bialystok

European Association for Education Law and Policy

University of Tirana

Aleksander Moisiu University of Durres

Belarusian State Pedagogical University named after Maxim Tank

Francisk Skorina Gomel State University

Moscow City University

Kutafin Moscow State Law University

Mari State University

Northern (Arctic) Federal University named after M.V.Lomonosov

National research university Higher school of economics

EKIPI I UNIVERSITETIT TË TIRANËS

Fakulteti i Shkencave Sociale

Emri	Roli në projekt
Prof. Dr. Nikoleta Mita	Koordinatorë rajonale e projektit, drejtuese institucionale e projektit eksperte e edukimit
Prof. Dr. Edmond Rapti	Ekspert i edukimit
Prof. Dr. Theodhori Karaj	Ekspert i edukimit dhe ekspert ligjor
Prof. Dr. Bardhyl Musai	Ekspert i edukimit
Dr. Nada Kallçiu	Ekspert e edukimit
Dr. Gerda Sula	Eksperte e edukimit
Dr. Livia Nano	Ekspert e e edukimit
Dokt. Rovena Sulstarova	Eksperte ligjore

MODULET

Në kuadrin e projektit do të përgatiten 14 module.

Fakulteti i Shkencave Soiale të Universitetit të Tiranës do të përgatisë Modulin 1 dhe 2.

Module 1: Legislating the quality triangle in education

Module 2: Regulation on the professional education EQF level 5 and its implementation

Module 3: Law on EU, federal, regional, municipal competences in education

Module 4: Law on the status of teachers, employment law relating to teachers

Module 5: Disciplinary procedures in schools and the duty of care, negligence and the duty of care and liability law

Module 6: Constitutional right to education, religious rights in education, religious freedom in education and litigation

Module 7: Legal framework on pedagogical and academic and school autonomy

Module 8: Non-discrimination and equality of pupils in education, law on inclusive education and pupils with special needs

Module 9: Comparative review of administration and governance of schools at central and/or regional level

Module 10: Law on teacher training and professional development of teachers

Module 11: Comparative review of law on school management in Europe

Module 12: Comparative review of law regulating school systems in Europe

Module 13: Privacy, transparency/ safety and violence in education, data protection, privacy, access to information

Module 14: Judicial review of teaching and assessment disputes; adjudication by the ECJ on recognition of qualifications and free movement of students and staff

• VEPRIMTARI

Veprimtari të Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës

Në kuadrin e projektit ndërkombëtar "Përgatitja e moduleve për legjislacionin dhe të drejtat në programet e mësuesisë dhe të shkencave të edukimit: një kontribut për të ndërtuar sisteme edukimi të bazuara në të drejtat në vendet në tranzicion", grupi i punës për hartimin e moduleve i Fakultetit të Shkencave Sociale të Universitetit të Tiranës ka organizuar disa takime pune gjatë muajit mars 2017. Ekipi i moduleve të FSHS të Universitetit të Tiranës është përgjegjës për përgatitjen e dy moduleve: Modul 1: "Legjislacioni për cilësinë në arsim" dhe Moduli 2: "Regullimi ligjor për arsimin profesional EQF nivel 5 and zbatimi i tij".

10 mars: Dy grupet e punës të përbëra nga Prof. Dr. Nikoleta Mita, Prof. Dr. Theodhori Karaj, Dr. Gerda Sula dhe Dr. Livia Nano diskutuan planin e punës për përgatitjen e moduleve dhe disa çështje të përbashkëta për formatin e modulit.

17 mars: Dy grupet e punës diskutuan kriteret për përzgjedhjen e shembujve dhe të rasteve të studimit. Në takim morën pjesë Prof. Dr. Bardhyl Musai dhe Nada Kallçiu si ekspertë të edukimit, Prof. Dr. Nikoleta Mita, Dr. Livia Nano dhe Dr. Gerda Sula si ekspertë të moduleve.

4 mars: Secili grup i modulit diskutoi tabelën e përmbajtjes së modulit.

Për më shumë shiko [PROJEKTI ERASMUS +](#)

Galeria






Fakulteti i Shkencave
5,064 likes

Adresa:
Tel:
Fax:
Email: fshs.it@unitir.edu.al
Email: info.fshs@unitir.edu.al



Be the first of your friends to like this



Copyright © 2015 FSHS Të gjitha të drejtat të rezervuara. Politikat e Privatësisë